

20150832739

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM
RURAL

Neni 1

Në Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15 dhe 73/15), në nenin 99 paragrafi (1) fjalët: "që nuk kanë trajtim të fatkeqësisë elementare" shlyhen.

Paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Lartësia maksimale e ndihmës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të tejkalojë 100% të humbjes së përcaktuar të të hyrave nga shitja e bimëve bujqësore dhe kafshëve të pronës bujqësore dhe dëmeve të serrave prej qelqi dhe serrave me plastmasë."

Pas paragrafit (9) shtohet paragrafi i ri (10), si vijon:

"(10) Lartësia e ndihmës nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet në pajtim me Programet vjetore nga neni 7 paragrafi (6) i këtij ligji."

Neni 2

Pas nenit 99-a shtohet titulli i ri dhe neni i ri 99-b, si vijon:

"Ndhma shtesë për pagesën e humbjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike

Neni 99-b

(1) Me përjashtim nga neni 99 të këtij ligji Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të miratojë vendim për ndihmë shtesë për pagesën e humbjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet e pavoritshme klimatike edhe personave që nuk janë shfrytëzues të mjeteve në pajtim me nenin 14 të këtij ligji.

(2) Në vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni do të përcaktohet lartësia maksimale e ndihmës e cila nuk guxon të tejkalojë 100% të humbjes së përcaktuar të të hyrave të nga shitja e bimëve bujqësore dhe kafshëve të pronës bujqësore dhe dëmeve të serrave prej qelqi dhe serrave me plastmasë në pajtim me rregullën nga neni 99 paragrafi (3) i këtij ligji.

(3) Ndhma shtesë nga paragrafi 1 i këtij neni do të paguhet si masë e paraparë në Programet vjetore nga neni 7 paragrafi (6) i këtij ligji."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".